





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr. 123/23
21.12.2023

Në mbështetje të nenit 26 paragrafi 1.11, nenit 32 dhe nenit 64 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, lidhur me kërkesën me nr. Prot. 312/22-01/H të datës 26.10.2022 si dhe ankesës së përsëritur e datës 10.09.2023 nga z. Hysni Mehani – Këshilltar komunal i Komunës së Skënderajt, për dhënien me qira të objekteve komunale, në mbledhjen e mbajtur me datën 21.12.2023 jep këtë:

REKOMANDIM

- I. Autoriteti i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluara, Praktikave të Bashkërenduara dhe realizimit të Përqendrimeve të paligjshme) nga ndërmarrjet private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet rregullatore në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të produkteve/shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.
- III. Komuna e Skënderajt ka dhënë në shfrytëzim objektin komunal për ma pak se një (1) vit, sipas kontratës me nr. Protokolli 05-353/01-0033203/22 të datës 05.09.2022, këtë kontratë sipas kërkesës së z. Hysni Mehani – Këshilltar komunal e ka shqyrtuar Autoriteti i Konkurrencës, dhe ka marr Konkluzion me nr. 82/23-02/D të datës 24.02.2023 ku ka konstatuar se dhënia në shfrytëzim e objektit komunal në fjalë është dhënë në mënyrë ligjore duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-092 dhe Rregullores nr. 01-463/01-0051690/20.
- IV. Me datën 11.09.2023 paraqitësi i iniciativës z. Hysni Mehani – Këshilltar komunal, nëpërmes email zyrtar të Autoritetit të Konkurrencës njofton se Kontrata e dhënë nga Komuna e

Skënderajt për 360 ditë ka skaduar dhe komuna e Skënderajt e ka përsërit të njëjtën kontratë të re me nr. 05-463/01-0045395/23/23 e datës 14.09.2023 edhe për 360 ditë me të njëjtin subjekt ekonomik.

- V. Autoriteti i Konkurrencës në këtë rast konsideron se është shterur/ezauruar, Kontrata me nr. Protokolli 05-353/01-0033203/22 të datës 05.09.2022 ndërmjet Komunës së Skënderajt dhe subjektit juridik “Ndona” Shpk me nr. unik identifikues: 810105454 të cilën e përfaqëson Znj. Naime Shabani.
- VI. Ligji nr. 06/L-092 dhe Rregullorja nr. 01-463/01-0051690/20, e parashohin se objektet komunale mund të jepen në shfrytëzim për 360 ditë pa procedura tenderimi, dhe vazhdimi i kontratës me të njëjtin subjekt ekonomik, pa procedura të Prokurimit Publik mendojmë se nuk në pajtim me legjislacionin, si vijon:
- Ligji nr. 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
 - Rregullore 01-463/01-0051690/20 për dhënien në shfrytëzim deri në një (1) vit të pronës së paluajtshme, objekteve, lokaleve dhe hapësirave publike në Komunën e Skënderajt;
 - Ligji nr. 05/L-056, për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- VII. Andaj, bazuar në pikën VI, REKOMANDOJMË Komunën e Skënderajt që të hap tregun, prona të jepet me qira sipas procedurave të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, për më shumë se 1 (një) vit, me procedura të shprehjes së interesit publik, ta japë në shfrytëzim pjesën e ndërtesës me nr. O-72015063-00047-22-1-3-0 dhe njësinë me nr. O-72015015063-00047-22-1-24-0 shfrytëzimi aktual Lokal pjesë e ndërtesës nr. 22-0 e ndërtuar ne ngastrën kadastrale nr. 47-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 132 m² në Skënderaj.
- VIII. Rekomandohet Komuna e Skënderajt që të ndër marr veprime për zbatimin e ligjit, hapjen e tregut dhe kthimin e konkurrencës tregtare në çështjen konkrete në mënyrë që të ju mundësoj qasje të barabartë, jo diskriminuese, jo favorizuese për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar për aplikim.
- IX. Rekomandohet Komuna e Skënderajt që të ndërpres kontratën Nr. 05-353/01-0033203/22 të datës 05.09.2022 dhe të filloj me procedurat e hapura konkurruese për dhënien në shfrytëzim të lokalit të lartcekur.

X. Përkitazi me çështjen në fjalë, Komuna e Skënderajt ta njofton me shkrim Autoritetin e Konkurrencës për zbatimin e këtij Rekomandimi, me qëllim mbrotjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Autoriteti jep këtë rekomandim nga pikëpamjet e Ligjit dhe politikave të konkurrencës.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**


Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare


Natije Osdautaj
Anëtare


Florent Mehmeti
Anëtar


Salihe Gashi-Loku
Anëtare

Me këtë Rekomandim të njoftohen:

- Komuna e Skënderajt;
- MAPL;
- Publikohet në Web faqen e Autoritetit;
- Pala ankuese;
- Arkiva.